

Festa e Shën Kollit/ Rama: Një ditë me dashuri dhe kujdes për veten e të afërmit tuaj



Kryeministri Edi Rama uroi sot besimtarët katolikë dhe ortodoksë për festën e Shën Kollit.

“Mirëmëngjes në këtë të diel të bekuar dhjetori që përkon me festën e Shën Kollit, ju uroj një ditë me dashuri dhe kujdes për veten e të afërmit tuaj”, – tha Kryeministri Rama.

Kryeministri Rama e shoqëroi urimin me një fotografi nga kisha e Shën Kollit në Voskopojë, Korçë.

6 dhjetori përkon me festën e Shën Nikollit, ipeshkv i shenjtë, të cilin Kisha e përkujton më 6 dhjetor. Shën Nikolli lindi në qytetin Patara në rajonin e Liçias në

Azinë e vogël (Turqia aktuale) në një familje mjaft të pasur.

Një legjendë tregon që Shën Nikolli ringjalli tre fëmijë që një kasap kishte vrarë e copëtuar për t'u shitur mishin. Për këtë episod Shën Nikolli është cilësuar si mbrojtësi i fëmijëve. Po kështu, Shën Nikolli gjithmonë thuhet se u përpoq që të bënte bamirësi fshehurazi dhe ta fshihte nga sytë e botës autorin e këtyre veprave të mira.

Sipas traditave dhe gojëdhënave, Zoti nëpërmjet këtij Shenjti kreu mrekulli pas mrekullie.

Shën Nikolli vdiq më 6 dhjetor të vitit 343. Kulti i tij u përhap me shpejtësi në të gjithë Azinë e Vogël. Mjafton të kujtojmë se vetëm në shek. VI, në Kostandinopojë iu kushtuan 25 kisha. Tek varri i tij filluan të organizoheshin pelegrinazhe. Shumë shkrime në greqisht e në latinisht e bënë të njohur figurën e tij në mbarë botën bizantine-sllave e perëndimore, duke filluar nga Roma e deri në jug të Italisë.

Shën Nikolli është i njohur edhe jashtë botës së krishterë, pasi mendohet se prej tij nis legjenda e Santa Claus-it (Klaus), Babagjyshit që sjell dhurata në fshehtësi.